



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:262656
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06511255

C-IV-14-7406

Paditësi:

- 1.C H– fshati Ll, Komuna e Deçanit**
- 2. Sh Sh – fshati Ll, Komuna e Deçanit (Gjallë)**

Kundër

E paditura:

- 1.Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë,

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja kryesuese Hajrie Shala, anëtarët Ganimete Puka gjyqtare dhe Hasim Sogojeva gjyqtar me dt.19 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit C H.**
- 2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit C H kërkojnë vazhdimin e procedurës.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.05.12.2014, paditësit kanë paraqitur padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër vendimit të AL-së PEJ018-0066 i dt. 12.11.2014, me të cilin kërkohet vërtetimi i së

drejtës së pronësisë së ngastrave kadastrale nr.,.,., dhe .. të evidentuara sipas fletës poseduese nr.. në ZK në KK H, nga KB “Deçani”.

Me 06 gusht 2024, gjykata ka kërkuar nga ankuesit plotësimin e padisë me prova shtese, por zarfi është me konstatimin se paditësi i parë C H ka vdekur.

Me dt. 05 nëntor 2024, gjykata ka tentuar për së dyti që të dërgoj urdhërin paditësit të dytë Sh Sh, i cili pastaj është përgjigjur në urdhërin e lartcekur duke sjellë prova shtesë, si kopjen e vendimit të AL-së, kopjen e njoftimit lidhur me likuidimin e KB “Deçani” në Deçan e dt. 07 prill 2006, kopjen e historiatit të pronës e dt. 17.03.2006 e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, kopjen e petitionit në emër të banorëve te fshatit Ll dhe kopjen e letërnjoftimit të tij.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit të parë C H

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse, sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.”*

Meqenëse padia është ushtruar nga dy paditës, ndërsa njëri ka ndërruar jetë, atëherë procedura sipas kësaj padie do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit C H, me parashtrësë kërkojnë vazhdimin e procedurës.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, gjyqtare kryesuese _____

Ganimete Puka, gjyqtare _____

Hasim Sogojeva, gjyqtar _____